



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1919 Prot.

Roskovec, më 28/04/2020

VENDIM

NR 31. DATË 27.04.2020

“PËR

DHËNIEN ME QIRA TË AMBIENTEVE PËRKATËSE PËR T’U PËRDORUR SI ZYRA ADMINISTRATIVE NGA ZYRA VENDORE ARSIMORE ROSKOVEC”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, gërma e); Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Kreu VI, nenet 801 dhe në vazhdim; Shkresës Nr. 654 prot, datë 13.02.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Dhënie me qira të ambienteve përkatëse për t’u përdorur si zyra administrative nga Zyra Vendore Arsimore Roskovec
2. Miratohet që të vendosen në funksion të Zyrës Vendore Arsimore 2 zyra në katin e parë të objektit 3 kate social për strehim në pronësi të Bashkisë Roskovec, me nr. Pasurie 2/441ND, zona kadastrale 3196, sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor me nr. 02, datë 24.04.2020.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit të Territorit, dhe Drejtoria Juridike me procedurat e hartimit të Kontratës së qirasë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Kadri Hyska

